



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

LISTË VERIFIKIMI PËR Inspektimin e ZVAP dhe DRAP për procedurat e ndjekura për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR Inspektimin e ZVAP dhe DRAP për procedurat e ndjekura për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar

Subjekti:

Nr.NIPT:

Adresa:

Administratori:

Drejtori i shkollës:

Tel/Cel:

Fax:

E-mail:

Lloji Aktivitetit:(ZVAP/DRAP)

Në zbatim të ligjit/ve nr.

datë

Për

VKM/ve nr.

datë

Për

BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023. *“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”*.
- Urdhër nr.454, datë 13.09.2019 *“Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nënpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”*.
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar me nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
---------	--------------	--------	---------------------------------------	---------

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
1	Gërma a, Pika 1, Neni 1, Kreu 1, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023.	A e ka njoftuar zyrtarisht Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP), menjëherë nga krijimi i vendit të lirë për drejtor të IPAP-së që ka në juridiksion, Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për vendin e lirë të punës dhe a e ka vënë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)?		
2	Gërma b, Pika 1, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023.	A e ka shpallur DRAP vendin e lirë të punës për drejtor, menjëherë nga njoftimi i ZVAP-së?		
3	Gërma c, Pika 1, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023.	A është shpallur vendi i lirë për drejtor të IPAP-së në faqen zyrtare të DRAP-së dhe të ZVAP-së, në këndin e njoftimeve të ZVAP-së dhe të IPAP-së, për të cilin bëhet shpallja e vendit të lirë për drejtor?		
4	Gërma a, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP-së?		
5	Gërma b, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit të tij?		
6	Gërma c, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor, datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit?		
7	Gërma d, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor, afatin e plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak të tij?		
8	Gërma e, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor, fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar?		
9	Gërma f, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor, datën e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyrën e komunikimit të tyre?		
10	Gërma g, Pika 3, Neni 1, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A përmban shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor të drejtën dhe afatet e ankimit për çdo fazë të konkurrimit?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
11	Gërma a, Neni 2, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e zotëron kandidati për drejtor i IPAP-së arsimimin si mësues, sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar?		
12	Gërma b, Neni 2, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e zotëron kandidati për drejtor i IPAP-së, kategorinë “Mësues i kualifikuar”, me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit?		
13	Gërma c, Neni 2, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A nuk ka patur kandidati për drejtor i IPAP-së masë disiplinore në fuqi?		
14	Gërma d, Neni 2, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është i certifikuar kandidati për drejtor i IPAP-së, nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar, ose a është pranuar për ta kryer atë?		
15	Gërma a, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, jetëshkrimin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi)?		
16	Gërma b, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, kopjen e librezës së punës?		
17	Gërma c, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, kopjen e dokumentit të identitetit (ID)?		
18	Gërma d, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi)?		
19	Gërma e, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor, në rast se e disponon?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
20	Gërma f, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, vetdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi)?		
21	Gërma g, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, vërtetimin nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi?		
22	Gërma h, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, deklaratën për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 8, të këtij udhëzimi?		
23	Gërma i, Pika 1, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e përmban dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP-së (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		
24	Pika 2, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është dorëzuar dokumentacioni i mësipërm nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike në ZVAP, për kandidatin për drejtor?		
25	Pika 2, Neni 3, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është kryer dorëzimi i dokumentacionit jo më vonë se dhjetë ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për drejtor të IPAP-së, në faqen elektronike zyrtare të DRAP-së, për drejtorin?		
26	Pika 1, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është ngritur Komisioni nga ZVAP-ja, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar?		
27	Gërma a, Pika 1, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka në përbërje Komisioni një përfaqësues të njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore ku ndodhet IPAP-ja?		
28	Gërma b, Pika 1, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka në përbërje Komisioni një përfaqësues i ZVAP-së që ka në juridiksion IPAP-në?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
29	Gërma c, Pika 1, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka në përbërje Komisioni kryetarin e bordit të IPAP-së?		
30	Gërma d, Pika 1, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka në përbërje Komisioni kryetarin e këshillit të prindërve të IPAP-së?		
31	Gërma e, Pika 1, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka në përbërje Komisioni dy mësues të IPAP-së, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve të tij?		
32	Pika 2, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është zgjedhur Kryetari i Komisionit nga titullari i ZVAP-së nga njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor?		
33	Pika 3, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka zgjedhur Këshilli i mësuesve të IPAP-së, si anëtarë të Komisionit, dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash?		
34	Pika 4, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A nuk janë anëtarët e Komisionit në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit?		
35	Pika 4, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A kanë plotësuar anëtarët në mbledhjen e parë të Komisionit, deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		
36	Pika 5, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A janë ftuar të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit pa të drejtë vote edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin?		
37	Pika 6, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është mbledhur Komisioni në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së, jo më vonë se tri ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP-së dhe kur kanë qenë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij?		
38	Gërma a, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka bërë Komisioni shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda dy ditëve pune, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
39	Gërma b, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka njoftuar Komisioni me shkrim/e-mail, aplikantët për mangësitë e konstatuara në dokumentacion?		
40	Gërma b, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka bërë aplikanti plotësimin e dokumentacionit brenda tri ditëve pune nga data e njoftimit?		
41	Gërma c, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka listuar Komisioni pas përfundimit të afatit të përcaktuar në shkronjën “b” të kësaj pike, aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni?		
42	Gërma d, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka vlerësuar Komisioni me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP-së, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		
43	Gërma e, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka realizuar Komisioni intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit?		
44	Gërma e, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka vlerësuar çdo anëtar i Komisionit intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune?		
45	Gërma f, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka hartuar Komisioni, tabelat e pikëve dhe renditur kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës?		
46	Gërma g, Pika 7, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka shpallur Komisioni brenda tri ditëve pune, në këndin e njoftimeve të IPAP-së, tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		
47	Pika 8, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A iu është dhënë e drejta kandidatëve të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit, brenda tri ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit?		
48	Pika 8, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka shqyrtuar Komisioni ankesat brenda një dite pune?		
49	Pika 9, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i ka dorëzuar Kryetari i Komisionit, drejtorit të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
50	Pika 9, Neni 4, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A janë ruajtur në arkivin e institucionit, kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat?		
51	Pika 1, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka shqyrtuar Sektori i Shërbimeve në ZVAP ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP-së, dokumentacionin e Komisionit dhe a e ka kthyer atë, vetëm nëse ka konstatuar parregullsi/mungesë në dokumentacionin e dorëzuar?		
52	Pika 2, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka përcjellë drejtori i ZVAP-së, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP?		
53	Pika 3, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka intervistuar titullari i DRAP dy kandidatët, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP-ja?		
54	Pika 4, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A janë dokumentuar intervistat nga sekretari i drejtorit të DRAP-së dhe a janë arkivuar në DRAP në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat?		
55	Pika 5, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka shpallur titullari i institucionit rajonal përgjegjës për arsimin parauniversitar, vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP-së, brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët?		
56	Pika 6, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i është dhënë e drejta kandidatit jofitues të paraqesë ankesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), brenda tri ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues?		
57	Pika 7, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka shqyrtuar MAS ankesën dhe a e ka dhënë përgjigjen brenda dhjetë ditëve pune, pas përfundimit të afatit të ankimit?		
58	Pika 8, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e ka bërë titullari i DRAP emërimin e drejtorit të IPAP-së?		
59	Pika 8, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i është komunikuar vendimi i emërimit zyrtarisht ZVAP-së?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
60	Pika 8, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i ka dërguar ZVAP-ja vendimin e emërimit drejtorit të sapoemëruar dhe drejtorit që drejton përkohësisht IPAP, sipas pikës 2, të nenit 8, të këtij kreu?		
61	Pika 9, Neni 6, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A nuk bën pjesë drejtori i IPAP-së pas emërimit në forumet drejtuese të partive politike?		
62	Pika 1, Neni 8, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka caktuar drejtori i DRAP-së nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP-së, në rastin kur nuk ka patur nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, kur drejtori i IPAP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk e ka ushtruar përkohësisht detyrën e tij?		
63	Pika 2, Neni 8, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka caktuar drejtori i DRAP-së nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP-së, në rastin kur nuk ka patur nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundim të procesit të konkurrimit sipas afateve të përcaktuara në kreun I, të këtij udhëzimi, kur vendi i drejtorit të IPAP-së është shpallur i lirë?		
64	Pika 3, Neni 8, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është shoqëruar me masë disiplinore drejtori i ZVAP-së, për tejkalimin e afateve të përcaktuara në kreun I, të këtij udhëzimi?		
65	Pika 1, Neni 9, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e ka kryer përkohësisht detyrën e drejtorit të IPAP-së drejtori zëvendësues, sipas nenit 8 të këtij kreu, në rastet kur nuk janë paraqitur aplikantë për drejtor ose ka patur vetëm një aplikant?		
66	Pika 1, Neni 9, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është rishpallur vendi për drejtor sipas procedurës së mësipërme?		
67	Pika 3, Neni 9, Kreu I, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A janë veçuar dy kandidatët për drejtor që kanë marrë më shumë pikë në intervistën e strukturuar përpara Komisionit, kur ka patur më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
68	Pika 1, Neni 10, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	<p>A ka mbaruar marrëdhënia e punës për drejtorin e IPAP-së, kur është konstatuar njëri nga rastet e parashikuara në shkronjën “ç” të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar?</p> <ul style="list-style-type: none"> - jep dorëheqjen; - mbush moshën e pensionit; - me vendim të komisionit mjekoligjor provohet paaftësia për kryerjen e detyrave; - merret masa disiplinore e largimit nga puna. 		
69	Pika 2, Neni 10, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	<p>A ka përfunduar në çdo rast marrëdhënia e punës, kur është konstatuar se drejtori është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale ose kur janë dënuar me vendim penal të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal?</p>		
70	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023, dhe pika “i”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	<p>A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “i” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka një vendim të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepre penale sipas 60/1 të ligjit 69/2012, i ndryshuar apo të një vepre penale që dënohet me burgim. 		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
71	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “ii”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	<p>A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “ii” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55:</p> <p>- pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IPAP-së</p>		
72	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “iii”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	<p>A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “iii” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55:</p> <p>- ka rast të përsëritur të shkeljeve për të cilat është ende në fuqi masa e vendosur nga Komisioni i Disiplinës “Paralajmërim për largim nga puna”.</p>		
73	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “iv”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	<p>A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “iv” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55:</p> <p>- ka kryer shkelje të procedurave të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe/ose të Maturës Shtetërore.</p>		
74	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “v”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	<p>A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “v” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55:</p> <p>- ka organizuar ose ka lejuar gjatë procesit mësimor pjesëmarrjen e mësuesve apo të nxënësve në veprimtari partiake ose ka marrë pjesë në to.</p>		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
75	Pika 2, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “vi”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “vi” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55: - konstatohet se pas emërimit, drejtori i IPAP-së bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike. Në këtë rast drejtori i institucionit vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar i kërkon zyrtarisht institucionit rajonal përgjegjës për arsimin parauniversitar shkarkimin e drejtorit të IPAP-së nga funksioni që kryen. Ky vendim merret jo më shumë se pesë ditë <i>pas marrjes së</i> kërkesës.		
76	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “vii”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “vii” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55: - IPAP-ja që ai drejton ka dy vlerësime të njëpasnjëshme “Dobët” nga institucioni vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar.		
77	Pika 1, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe pika “viii”, shkronja “c”, e pikës 5, neni 55, ligji 69/2012 i ndryshuar.	A ka filluar titullari i DRAP-së procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative, në rastet e parashikuara në pikat “viii” të shkronjës “c”, të pikës 5, neni 55: - kur ka kryer veprimtari në kundërshtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri përgjegjës për arsimin parauniversitar.		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
78	Pika 3, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023 dhe nënplikat “i” dhe “ii” të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar.	<p>A ka marrë drejtori i DRAP-së, pas njoftimit zyrtar të drejtorit të ZVAP-së, për rastet e parashikuara në nënplikat “i” dhe “ii” të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, nëse kanë filluar hetime paraprake ndaj drejtorit të IPAP-së, vendimin e pezullimit të drejtorit të IPAP-së, deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente?</p> <p>- “i” gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal ndaj tij ose;</p> <p>- “ii” është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji.</p>		
79	Pika 4, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e ka paralajmëruar drejtori i DRAP drejtorin e IPAP-së për shkarkim, kur është provuar se ai nuk ka marrë masë për largim nga puna ndaj mësuesit, kur mësuesi ka kryer shkelje që parashikohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin që rregullon procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në IPAP?		
80	Pika 4, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A e ka shkarkuar drejtori i DRAP-së, drejtorin kur e ka përsëritur këtë veprim më shumë se një herë?		
81	Pika 7, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i është dhënë e drejta drejtorit të IPAP-së, të dëgjohet nga titullari i institucionit para se të merret vendimi i shkarkimit të tij?		
82	Pika 7, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është dokumentuar dhe arkivuar seanca dëgjimore?		
83	Pika 8, Neni 11, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është ruajtur në arkivin e institucionit, në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat, vendimi i drejtorit të DRAP për pezullimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të IPAP-së?		
84	Pika 1, Neni 12, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka referuar ZVAP-ja menjëherë vlerësimin në DRAP, në rast se, pas vlerësimit vjetor të performancës, drejtori në detyrë i IPAP-së rezulton me performancë jo të kënaqshme?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
85	Pika 2, Neni 12, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A i ka dhënë drejtori i ZVAP-së, të drejtën për t'u dëgjuar drejtorit, që rezulton me performancë jo të kënaqshme, brenda pesë ditëve nga njoftimi?		
86	Pika 3, Neni 12, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka vendosur titullari i DRAP uljen në detyrë të drejtorit të IPAP-së dhe kalimin e tij në pozicionin mësues në profilin e tij, brenda të njëjtit institucion arsimor ose në një institucion arsimor, brenda të njëjtit institucion arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni?		
87	Pika 5, Neni 12, Kreu II, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A ka kaluar në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij drejtori në detyrë të IPAP-së, në rast se në institucionin që drejton, është ulur numri i nxënësve nën normën që përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi?		
88	Pika 6, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i janë llogaritur mësuesit që përgatit nxënës për fazën e dytë dhe të tretë të olimpiadave, ose për pjesëmarrje në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, dy orë mësimore në javë si orë mbi normë/ngarkesë për periudhën e angazhimit?		
89	Pika 1, Neni 13, Kreu III, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A nuk është marrë përjashtimisht si kriter i detyrueshëm trajnimit dhe pajisja me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor, për një periudhë dyvjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 44, datë 15.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshimin në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”?		
90	Pika 2, Neni 13, Kreu III, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është emëruar përkohësisht kandidati fitues nga titullari i DRAP-it për drejtorin për një periudhë njëvjeçare, në rastet kur nuk kanë plotësuar kushtin sipas shkronjës “d”, të nenit 2, kreu I, të këtij udhëzimi?		
91	Pika 2, Neni 13, Kreu III, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A është rishpallur procedura për përzgjedhjen e drejtorit të IAP-së, sipas kreu I, të këtij Udhëzimi, pas përfundimit të periudhës së mësipërme?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
92	Pika 3, Neni 13, Kreu III, Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023	A kanë aplikuar drejtorët në detyrë, për vijimin e detyrës, përveç kritereve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, për t’u pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor dhe certifikimin nga shkolla e drejtorëve?		
93	Gërma f, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019, dhe pika 1, neni 14, kreu III, të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019.	A propozon grupi i inspektimit për masë disiplinore ndaj personave përgjegjës në ZVAP për shkeljet e konstatuara?		
94	Gërma f, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019, dhe pika 1, neni 14, kreu III, të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019.	A propozon grupi i inspektimit për masë disiplinore ndaj drejtuesit të DRAP për shkeljet e konstatuara?		
95	Gërma b, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.	A jep grupi i inspektimit rekomandimet përkatëse për shkeljet e konstatuara?		

INSPEKTORËT